

VENDIM
Nr.218, datë 6.3.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 168 e vijues e 181 e vijues, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë, ndërmjet KESH, sh.a.-së, dhe Bankës Europiane të Investimit, në shumën 2,3 (dy presje tre) miliardë lekë, dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shumën 2,68 (dy presje gjashtëdhjetë e tetë) miliardë lekë, sipas specifikimeve, të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, detyrimet e të cilave nuk do t’i transferohen OSSH, sh.a.-së.”.

2. Pas pikës 5/2 shtohen pikat 5/3, 5/4 e 5/5, me këtë përmbajtje:

“5/3. Asetet e financuara nga kreditë afatgjata, të përfunduara gjatë vitit 2008, nga KESH, sh.a., për OSSH, sh.a.-në, në shumën 1,1 (një presje një) miliard lekë, t’i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sh.a.-së, dhe të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta pasqyrojë këtë transferim në formën e uljes së kapitalit të KESH, sh.a.-së, dhe të rritjes së kapitalit të OSSH, sh.a.-së, përkatësisht në vlerën e përcaktuar më lart.

5/4. Detyrimet afatshkurtra, për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifën e transferimit, që OSSH, sh.a., ka, respektivisht, ndaj KESH, sh.a.-së, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a.-së, deri në shumën 1 (një) miliard lekë, të shuhën dhe të pasqyrohen si rritje kapitali e OSSH, sh.a.-së.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

5/5. Shuma prej 0,53 (zero presje pesëdhjetë e tre) miliardë lekë, që i korrespondon pagimit të huave afatgjata, në vitin 2008, nga KESH, sh.a., të pasqyrohet si rritje kapitali për OSSH, sh.a.-në.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca 1

Specifikimet e kredive:

1. Marrëveshja e kredisë (numër 3671) së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e ristrukturimit dhe të rehabilitimit të sektorit të energjisë elektrike e datës 26 qershor 2002, në shumën ekuivalente me njëzet e katër milionë të drejta të veçanta të tërheqjes (SDR) (24 000 000) ose 2,68 miliardë lekë, në periudhë maturimi njëzet (20) vjet dhe interes të barabartë me Libor plus 0,75% e ratifikuar me ligjin numër 8941, datë 19.9.21002.

2. Marrëveshja e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Bankës Europiane të Investimit për projektin e përmirësimit të kapacitetit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, e datës 30 tetor 2001, në shumën tridhjetë milionë euro (EUR) (30 000 000) ose 2.3 miliardë lekë, me periudhë maturimi tetëmbëdhjetë (18)vjet dhe interes të barabartë me Euribor plus 0.75%.